

Camden Së Bashku
Strategjia e qëndrueshme e komunitetit të Camden-it 2007-2012

Parathënie

Ne jemi të kënaqur t'ju prezatojmë strategjinë e re të qëndrueshme të komunitetit për Camden-in në emër të Partneritetit Strategjik Lokal (LSP). Kjo strategji paraqet vizionin tonë të përbashkët për të ardhmen e Camden-it.

Ne kemi dëgjuar mendimet e njerëzve. Për zhvillimin e këtij vizioni këshilltarët e zgjedhur zhvilluan mbledhje publike në gjithë bashkinë, në të cilat morrën pjesë qindra njerëz për të dhënë pikëpamjet e tyre. Forumi qytetar bashkoi rezidentët, biznesin dhe shërbimet publike për një shqyrtim të thellë të disa prej problemeve më të vështira me të cilat përballet Camden-i. Në tërësi, më shumë se 1200 njerëz patën një rol aktiv në konsultim.

Vizioni i përgjithshëm është që Camdeni të jetë një *bashki e mundësive*. Kjo do të thotë të punojmë së bashku që t'u japim mundësi individëve dhe komuniteteve të arrijnë potencialin e tyre të plotë, në lidhje me punën dhe jetën e tyre sociale.

Ne duam që njerëzit në Camden të jetojnë në komunitete të sigurta dhe në harmoni, të ndihen të lidhur me vendin ku jetojnë dhe duke e ditur se ata mund të ndikojnë tek çfarë ndodh rreth tyre.

Ne duam të trajtojmë dilemat kryesore me të cilat përballet bashkia dhe të punojmë së bashku për të gjetur zgjidhjet. Kjo do të thotë të përshtatemi ndaj një popullsie në rritje, ndërkohë që të ruajmë – në të vërtetë të përmirësojmë – cilësinë e jetës për ne dhe për brezat e ardhshëm. Një sfidë tjetër është të sigurojmë që Camdeni të bëhet një vend më i sigurt ndërkohë të ruajmë gjallërinë që e bënë atë një vend kaq interesant për të jetuar.

Kjo strategji paraqet mënyrën se si mund të punojmë së bashku për të sjellë ndryshimin e vërtetë në Camden. Kjo është arsyeja që ne po prezantojmë një strategji të komunitetit të ndërtuar rreth një vizioni ambicioz dhe angazhimesh të qarta.

Ne, dhe pjesa tjetër e Partneritetit Strategjik Lokal, jemi të angazhuar të sigurojmë që në 2012 Camden-i të jetë një vend i mundësive - për këdo.

Këshilltar Keith Moffitt

Kryetar i Partneritetit Strategjik Lokal dhe Kryetari i Këshillit

Këshilltar Andrew Marshall

Zëvendës Kryetar i Këshillit.

Mars 2007

1. Hyrje

Çfarë është Camden së Bashku?

Camden Së Bashku është strategjia për bashkinë nga tani e deri në 2012.

Në zemër të strategjisë së komunitetit – për këtë arsye është quajtur një strategji e *qëndrueshme* e komunitetit - është një angazhim për Camden-in që të zhvillohet në mënyrë të tillë që përmirëson cilësinë e jetës për ne dhe për brezat e ardhshëm. Kështu Camden së Bashku ka një fokus të fortë në bashkimin e çështjeve sociale, ambientaliste dhe ekonomike. Për shëmbull, ne duhet të përshtatemi ndaj rritjes ekonomike dhe të popullsisë në një mënyrë të tillë që ajo zvogëlon gjurmët tona të karbonit, ruan hapësirat tona të gjelbra, plotëson nevojat për strehim në bashki dhe forcon infrastrukturën që nevojitet për të përkrahur komunitetin tonë.

Strategjia është njëra anë, veprimi real që sjell ndryshim në jetën e njerëzve është ana tjetër. Angazhimet në këtë dokument bazohen më tepër në atë ç'ka është e rëndësishme për popullin e Camden-it se sa ç'është e vlefshme për organizatat. Me qëllim që të arrijmë angazhimet tona, është e rëndësishme që të gjithë ne të punojmë së bashku. Për këtë arsye strategjia e komunitetit është zhvilluar ngushtë me Partneritetin Strategjik Lokal – një grup që drejtohet nga Kryetari i Këshillit që përfaqëson ofruesit e shërbimeve publike të Camden-it, përfshirë policinë dhe shërbimet lokale shëndetësore si dhe biznesin lokal dhe sektorin e komunitetit dhe vullnetar.

Ofrimi i shërbimeve të shkëlqyera publike që u përgjigjen nevojave të njerëzve në bashki është një pjesë e çështjes, por në asnjë mënyrë nuk është gjithçka. Dhe kjo strategji nuk është thjesht rreth çështjes se çfarë mund të bëjnë agjensitë publike. Njerëzit kanë të drejtë të shprejnë nga Council-i dhe partnerët e tij të konsultojnë, të caktojnë drejtimin dhe të ofrojnë një udhëheqje të qartë. Por secili është përgjegjës, sa të jetë e mundur, për të ndihmuar në plotësimin e angazhimeve të paraqitura në këtë strategji.

Konsultimi

Konsultimi për Camden Së Bashku u zhvillua midis Shtatorit dhe Nëntorit 2006. Mbi 1200 njerëz u përfshinë aktivisht në konsultim dhe ne morrëm 263 përgjigje me shkrim dhe me anë të email-it nga individët, duke përfshirë 91 përgjigje nga fëmijët dhe të rinjtë. Kishte 51 përgjigje nga organizatat dhe 374 njerëz morrën pjesë në mbledhjet e drejtuara nga këshilltarët e zonave.

Ne zhvilluam dhe një sërë ngjarjesh konsultimi përveç mbledhjeve të këshilltarëve të zonës, duke përfshirë mbledhje me grupe specifike të rezidentëve, konsultimi për qëndrueshmërinë dhe për çështjet e biznesit, puna me shkollat dhe një forum qytetar i mbajtur në Shkollën Haverstock. Ju mund të mësoni më tepër në websit-in www.camdentogether.org.uk. Ky sit do të jetë gjithashtu një burim informacioni i vazhdueshëm rreth strategjisë së re të qëndrueshme të komunitetit të Camden-it.

Disa mesazhe që u përcollën fuqimisht nga konsultimi përfshinin të mëposhtmet:

- **Strehimi**
Shumë njerëz mendonin se strehimi në bashki ishte një çështje e rëndësishme. Në veçanti, njerëzit e ndjenin se kishte një mungesë strehimi të përbalueshëm nga ana financiare ose të përshtatshëm për nevojat e tyre.
- **Droga dhe krimet e tjera**
Njerëzit e ndienin se përdorimi dhe shitja haptazi e drogës në bashki dobëson seriozisht cilësinë e jetës. Në përgjithësi lufta kundër kimit dhe çështja e sigurisë ishin prioritet për banorët për të përmirësuar Camden-in në të ardhmen.
- **Dyqanet e pavaruara lokale dhe biznesi**
Njerëzit çmonin gamën e biznesit lokal- veçanërisht dyqanet e pavarura lokale – dhe dëshironin që ky diversitet të ruhet.
- **Çështjet e Ambjentit**
Kishte përkrahje të fuqishme për një qëndrim më aktiv për mbrojtjen e ambjentit dhe përpjekjet ndaj ndryshimit të klimës. Njerëzit donin të ishte më e lehtë për ta, që të jepnin kontributin e tyre.
- **Menaxhimi i rritjes**
Në numër i madh i atyre që u përgjigjën e ndjenin se Camden-i do të ketë vështirësi të përballet me një popullsi në rritje dhe disa mendonin se banorët ekzistues duhet të kenë prioritet.
- **Diversiteti**
Kishte një përkrahje të konsiderueshme për diversitetin e Camden-it dhe, në veçanti, shumë njerëzve u pëlqente të banonin përkrah njerëzve me origjinë të ndryshme. Shumë njerëz mendonin gjithashtu se gjuha angleze ishte e rëndësishme për ta mbajtur të bashkuar komunitetin tonë.
- **Nxitja e përgjegjësisë personale**
Njerëzit e mbështetën idenë se secili kishte një rol për të luajtur për ta bërë Camden-in një vend më të mirë për të banuar. Shumë thanë se shikonin nga Council-i për udhëheqje, por e pranuan gjithashtu se Council-i ka shumë gjëra për të bërë. Mendohej gjithashtu se njerëzit kishin nevojë për përkrahje dhe nxitje që të ishin në gjendje të merrnin vetë përgjegjësi.

Pati gjithashtu mesazhe të qarta, për shembull, nga fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit, mesazhe të cilat janë reflektuar gjatë gjithë strategjisë. Mesazhet nga konsultimi kanë ndihmuar në formimin e angazhimeve që paraqiten në këtë strategji.

Si do të realizohet Camden së Bashku

Camden së bashku paraqet vizionin për Camden-in në 2012, me prioritetet të qarta ku duhet të përqëndrohemi për ta bërë realitet këtë vision. Është një strategji ambicioze sepse trajton – fuqishëm - sfidat kryesore me të cilat përballemi për ta bërë Camden-in një bashki të mundësive.

Për Council-in dhe shërbimet e tjera publike, Camden së Bashku do të caktojë drejtimin për punën tonë gjatë pesë viteve të ardhshme. Vizioni do të ofrojë kontekstin për të gjitha strategjitë dhe planet tona të tjera, duke përfshirë plane partneriteti të rëndësishme (si plani për Të Rinjtë dhe Fëmijët e Camdenit) dhe planet e organizatave individuale (si Plani i Korporatave të Council-it).

Ne do të botojmë objektivat dhe treguesit kryesorë që do të përdorim për të matur suksesin në Marrëveshjen e Zonës Lokale të Camden-it. Kjo do të paraqes hollësisht përmirësimet specifike që duam të shohim çdo vit dhe performancën tonë në vite. Ne do të përgatisim një raport çdo dy vjet për Partneritetin Strategjik Lokal mbi progresin e bërë në lidhje me angazhimet që paraqiten në këtë strategji. Kjo do të monitorojë shkallën e realizimit të angazhimeve nga Council-i dhe partnerët e tij.

Kjo strategji nuk ka të bëjë vetëm me faktin se çfarë mund të bëjnë shërbimet publike, por ajo paraqet gjithashtu rolin e biznesit, komuniteteve dhe individëve. Ne do të botojmë informacion rreth mënyrës se si këto grupe po kontribuojnë për ta bërë realitet vizionin.

Është e rëndësishme të kuptojmë dhe monitorojmë ndikimin e kësaj strategjie të komunitetit në aspektet e ndryshme të jetës në bashki. Kjo bëhet për të siguruar që strategjia të mos ketë ndikim diskriminues në grupe të veçanta ose të mos dëmtojë ambjentin ose shëndetin e popullsisë lokale. Për këtë arsye strategjia e komunitetit do të kontrollohet për ndikimin e saj në shëndetësi, ambjent, diversitet dhe barazi. Vlerësimi i ndikimit do të reflektohet dhe përditësohet në raportin e progresit mbi strategjinë e komunitetit, raport që bëhet çdo dy vjet.

Vlerat e Camden Së Bashku

Ka dy parime kryesore që përkrahin qëndrimin e Camden Së Bashku

- Secili nga ne si individ duhet të marrë **përgjegjësi për veprimet tona**. Përgjegjësia personale përmirëson cilësinë e jetës tonë dhe siguron që Camden-i të bëhet një vend më i mirë për të jetuar. Kjo do të thotë të kujdesemi vetë për shëndetin tonë, të respektojmë të tjerët dhe të kujdesemi për ambjentin tonë.
- Na nevojitet gjithashtu **të punojmë së bashku**, si qytetarë që kontribuojmë aktivisht tek komuniteti jonë lokal dhe si organizata - duke përfshirë biznesin lokal, sektorin publik dhe sektorin vullnetar dhe të komunitetit- të ndihmojmë në zgjidhjen e sfidave për bashkinë. Puna së bashku forcon dhe nxit një sens komuniteti.

Partneriteti Strategjik Lokal.

Partneriteti Strategjik Lokal i Camden-it (LSP) drejtohet nga Council-i dhe përfshin shërbimet shëndetësore, policinë, shërbime të tjera publike, biznese të vogla dhe të mëdha dhe përfaqësuesit nga sektorët vullnetarë, të komunitetit dhe sektorë të tjerë. LSP ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e jetës për të gjithë ata që jetojnë, punojnë ose që vizitojnë bashkinë. Anëtarët e partneritetit janë paraqitur më poshtë:

- Kryetari i Council-it i cili është dhe Kryetar i LSP dhe Zëvendës Kryetari i Council-it
- Shefat Ekzekutiv të Council-it dhe Trusti i Kujdesjes Primare.
- Komandantët e Shërbimeve të Zjarrfikseve dhe Policisë të Bashkisë.
- Rrjeti i Autorizimit të Komunitetit të Camden-it, i cili përfaqëson sektorin vullnetar dhe të komunitetit në bashki.
- Jobcentreplus, Shoqata e Strehimit të Camdenit dhe Forumi Co-op, Këshilli i Aftësive dhe të Mësuarit, Lidhja e Kryetarëve të Guvernatorëve të Shkollës, Camden Town Unlimited, Partneriteti i Holborn-it, Pronat dhe Stacionet e Londrës dhe Kontinentit dhe Universiteti College London.

LSP ka miratuar vizionin dhe angazhimet në strategji dhe do të monitorojë aplikimin e tij. Kjo do të përfshijë anëtarët e LSP për të çuar përpara angazhimet dhe për të siguruar që vetë LSP të jetë e aftë për të plotësuar qëllimet e saj. Megjithatë, përgjegjësia ligjore për strategjinë bie mbi Council-in dhe pësedhjetë e katër këshilltarët e zgjedhur nga votuesit e Camden-it.

Shpenzimet e Sektorit Publik në Camden

Çdo vit në Camden ka një investim dhe shpenzim të konsiderueshëm nga shërbimet publike të financuar në shkallë lokale, rajonale dhe kombëtare. LSP e njej rëndësinë e shërbimeve publike që të punojnë së bashku, me qëllim që të ofrojmë vlerën më të mirë për paratë e taksapaguesve. Prandaj ne po japim një pamje të shpenzimeve totale të sektorit publik në bashki.

Tabela e mëposhtme paraqet disa nga fushat kryesore të shpenzimeve në bashki. Shifrat përfaqësojnë shpenzimet brënda bashkisë së Camden-it. Shumë nga këto shërbime u ofrojnë asistencë jo vetëm banorëve të Camden-it, por gjithashtu edhe shumë banorëve jo të Camden-it që punojnë, studiojnë ose janë këtu si vizitorë.

Shifrat treguese të shpenzimeve në Camden për 2005/2006	
Council-i	
Bashkia Camden ¹	£897,300,000
Siguria e Komunitetit	
Policia Metropolitane (Buxheti i Seksionit Drejtues Operacional të Bashkisë)	£40,100,000
Policia Metropolitane (shuma paraprake shtesë e shpenzimeve)*	£54,000,000
Shërbimi i Prokurorisë	£5,800,000
Zjarrfikset dhe planifikimi emergjent	
Zjarrfikset e Londrës dhe Autoriteti i Planifikimit Emergjent*	£13,000,000
Shërbimi Shëndetësor Kombëtar	
Trusti i Kujdesjes Primare ²	£470,890,000
Transporti	
Transport për Londrën (përfshirë në buxhetin e Council-it)	£9,095,000
Transport për Londrën (shuma paraprake shtesë e shpenzimeve)*	£125,000,000
Arsim i Mëtejshëm	
Këshilli i Aftësive dhe të Mësuarit ³	£42,500,000
Sfera të tjera rajonale	
Agjensia e Zhvillimit të Londrës*	£11,200,000
Autoriteti i Greater London*	£2,100,000
Departamenti për Punë & Pensione dhe HM Taksave dhe Doganave	
Benefitet, asistencë e rregullt, kreditet e taksave dhe pensionet ⁴	£323,000,000

Sektori vullnetar dhe i komunitetit japin gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në punën e LSP në bashki duke gjeneruar dhe riinvestuar të ardhura, duke sjellë financime nga burime të tjera dhe nëpërmjet vlerës së kohës së vullnetarëve.

¹ Deklarata e Llogarive të Camden-it 2005-6. Shpenzimet e Council-it mbulojnë një gamë të gjerë shërbimesh nga financimi i shkollave deri tek shërbimi i kujdesjes sociale për të rriturit & benefitet e strehimit/taksës së council-it.

² Raporti vjetor i Camden PCT 2005-06. PCT kontrillojnë 80 per qind të buxhetit of total të NHS-it.

³ Shifra është me përafërsi bazuar në të dhënat e hollësishme lokale.

* Shifrat janë me përafërsi bazuar në llogaritë rajonale (Niveli Londër) pjestuar nga numri i Bashkive të Londrës. Buxheti i Autoritetit të Greater London është dhënë vecmas nga katër organizmat e tij funksional: Policia, Zjarrfikset, TfL dhe LDA

⁴ Bazuar në statistikë nga DWP dhe HMRC. Përfshin Disability Allowance, Incapacity Benefit / Severe Disablement Allowance, Income Support, Jobseekers Allowance, Kredit Pensioni, Pensionin Shtetëror, Attendance Allowance, Kredit Taksa e Punës, Kredit Taksa e Fëmijëve, Benefitit i Fëmijëve.

Kapitulli Dy: Vizion

Vizioni ynë i përgjithshëm për bashkinë është që:

Camden-i në 2012 do të jetë një bashki e mundësive

Një Camden i qëndrueshëm që adaptohet me rritjen e popullsisë	Një ekonomi e fortë e Camdenit që përfshin këdo.
Ne do të gjejmë mënyra për t'u adaptuar me rritjen e popullsisë së Camden-it, ndërkohë që mbrojmë, nxisim dhe përmirësojmë ambjentin për ne dhe për brezat e ardhshëm.	Ekonomia e Camden-it do të jetë më e fortë dhe më shumë banorë të Camdenit, veçanërisht të rinj do të kenë aftësitë, arsimin dhe trajnimin për të marrë pjesë në tregun e punës.
Një komunitet i lidhur i Camden-it ku njerëzit bëjnë një jetë aktive, të shëndetëshme.	Një Camden i sigurt që është pjesë e gjallërisë së qytetit tonë botëror.
Camden-i do të ketë një ndenjë më të madhe të komunitetit dhe individët do të përkrahen për të qënë qytetarë aktivë që mund të ndikojnë në vendimet lokale dhe të bëjnë një jetë të shëndetshme.	Camden-i do të jetë një vend më i sigurt, ku njerëzit lokalë mund të përfitojnë nga mundësitë kulturore dhe argëtuese duke përfshirë Lojërat Olimpike të Londrës.

Kapitulli tre: Faktet e Camden-it

Është e rëndësishme të bëjmë planet tona të së ardhmes duke u mbështetur në kuptimin e bashkisë sot dhe gjithashtu si ajo ka të ngjarë të ndryshojë me kalimin e kohës.

- Camden-i është një bashki energjike e Londrës me një popullsi diverse dhe shumë njerëz vijnë dhe ikin nga bashkia çdo vit.
- Camdeni ka një propocion të madh të njerëzve midis moshës 20 dhe 44 vjeç.
- Ne e dimë se popullsia jonë do të qëndrojë relativisht e re, me shumicën e popullsisë tonë që qëndron nën moshën pesëdhjetë vjeç.
- Popullsia jonë ka gjithashtu të ngjarë që të rritet deri më 10% gjatë dhjetë viteve të ardhshme, në qoftë se vazhdon me ritmin e tanishëm. Kjo rritje ka mundësi që t'i vendosë shërbimet lokale dhe strehimin nën një presion në rritje.
- Camden nuk është vetëm një vend për rezidentët, pothuajse një çerek milion njerëz punojnë këtu çdo ditë dhe bashkia tërheq një numër të madh vizitorësh çdo vit.
- Ekonomia jonë është e fortë – duke kontribuar deri në 1% të ekonomisë kombëtare-por shumë njerëz lokalë, veçanërisht ata që banojnë në strehimin social dhe ata që kanë disavantazhe për shkak të aftësive të kufizuara ose sëmundjeve, janë pa punë.
- Camden-i ka disa nga lagjet nga më të pasura në Londër dhe disa nga më të privuarat.
- Një e treta e fëmijëve në Camden jetojnë në familjet që mbështeten në asistencën sociale të shtetit.
- Por tre nga katër njerëz mendojnë që lagjet kanë një ndjenjë të mirë komuniteti.
- Kërkesa për strehim të përballeshëm nga ana financiare është shumë më e madhe se sa ka strehim të disponueshëm dhe pothuajse një e treta e shtëpive të Camdenit janë të mbipopulluara.
- Krimet e dënueshme kanë rënë në përgjithësi, por Camdeni has krimin që prek shumë zona të brendshme të qytetit dhe krimi vazhdon të jetë një shqetësim kryesor i publikut.
- Camdeni ka një numër relativisht të lartë – 4218 – të përdoruesve problematikë të drogës, por gjithashtu po ecën mirë dhe në lidhje me numrin e përdoruesve që ndjekin programet e trajtimit.
- Pothuajse gjysma e banorëve të Camden-it kanë kualifikime të paktën në nivelin universitar, ndërsa çereku ka pak, ose aspak, kualifikime.
- Në 2006 Camdeni zinte vendin e shtatë në shkallë kombëtare në vlerën e shtuar nga shkollat fillore, ndërsa shkollat e mesme arritën rezultat më të larta se çdo herë në GCSE për notat A* deri në C në shkallën 55%.

- Rreth 35% e popullsisë së Camdenit pi duhan krahasuar me 25% në Angli dhe rreth 17% e vdekjeve në Camden shkaktohen nga pirja e duhanit
- Ka një diferencë prej më shumë se 11 vjet në moshën mesatare të meshkujve midis Hampstead Town dhe St Pancras dhe Somers Town.
- Emetimet e dioksidit të karbonit në Camden janë të barabarta me afërsisht një milion e gjysëm fluturime në New York ose afërsisht nëntë ton për banor.

Një Camden i qëndrueshëm që përshtatet ndaj një popullsisë në rritje.

Camden-i përballlet me sfidat e ambjentit që sa vijnë e rriten gjatë dekadës së ardhshme, duke përfshirë dhe rritjen e popullsisë. Lokalisht, një popullsi më e madhe do të thotë më shumë banorë, biznese dhe vizitorë që kanë nevojë për më tepër hapësirë për ndërtesa, do të rrisin përdorimin e energjisë dhe mundësia për më shumë trafik. Neve do të na duhet të punojmë së bashku për të menaxhuar infrastrukturën sociale, shëndetësore, ekonomike dhe arsimore për të përkrahur popullsinë në rritje.

Ndryshimi klimatik po na prek të gjithëve dhe duhen marrë masa urgjente. Ne jemi të angazhuar të punojmë për një Camden të qëndrueshëm që përshtatet ndaj rritjes së popullsisë, ndërsa mbron, promovon dhe përmirëson ambjentin

Të mbrojmë ambjentin për veten tonë dhe për brezat e ardhshëm.

Qëllimi jonë është që ta bëjmë Camden-in një bashki me karbon të ulët dhe mbetje të ulta brenda 2012

Pse kjo çështje është e rëndësishme

Ndryshimi klimatik është një prioritet urgjent dhe shërbimet publike në Camden janë të angazhuar të bëjnë atë pjesë të punës që na takon për të ulur emetimet e dioksidit të karbonit, gazit kryesor të ndryshimi të klimës, në përputhje me objektivat kombëtare. Më shumë se gjysma e gazeve që shkaktajnë ndryshimet klimatike vijnë nga bizneset dhe çereku vjen nga shtëpitë. Të gjithë ne duhet mendojmë se si të zvogëlojmë 'gjurmën tonë të karbonit'.

Por mbrojtja, promovimi dhe përmirësimi i ambjentit është një shqetësim më i gjerë se sa ndryshimi klimatik. Dhe na takon ne të gjithëve të sigurohemi që ne t'i përdorim me mençuri burimet natyrore; të zvogëlojmë, të ripërdorim dhe të riciklojmë mbeturinat tona; të mbrojmë bimët dhe botën e egër gjalore dhe të zvogëlojmë ndotjen. Ne duhet ta bëjmë më të lehtë për njerëzit, që ata ta ulin impaktin e tyre tek ambjenti.

Çfarë është bërë tashmë.

Për vite me radhë, ne kemi bërë një punë të mirë për zvogëlimin e mbeturinave dhe për riciklimin. Në vitin 2006 niveli i riciklimit tonë prej 27% ishte më i larti në Londrën e brendshme. Bashkia po ul gjithashtu dhe nivelet e trafikut, të cilat kanë rënë mbi 20% që nga 1993 nëpërmjet, për shembull, kontrolleve të parkimit.

Council-i u ofron grante rezidentëve në të gjitha llojet e strehimit për të përmirësuar efikasitetin e energjisë të shtëpive të tyre dhe ka kursyer

ekuivalentin e energjisë për ngrohjen e 3900 shtëpive nëpërmjet izolimit dhe vendosjes së xhameve të shtëpive që ka në gjendje.

Shkollat e Camden-it po ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë që të kenë një mënyrë jetese të qëndrueshme, për shembull duke i përfshirë ata në projektimin e ambientit të shkollës.

Këto janë disa nga qëllimet specifike që synojmë të arrijmë:

- Ta bëjmë strehimin që është në pronësi të Council-it më eficient ndaj energjisë.
- Rritjen e sasisë së mbeturinave që riciklohen apo që bëhen pleh.
- Uljen e sasisë së mbeturinave që grumbullohet për banor.
- Uljen e trafikut

Çfarë na thanë njerëzit

Gjatë konsultimit ne morrëm shumë komente mbi çështjet e ambientit. Njerëzit mendojnë se ndryshimi i klimës është një çështje e rëndësishme dhe ata duan të luajnë rolin e tyre dhe për Council-in dhe partnerët e tij të kenë një rol udhëheqës lokalisht.

Njerëzit duan që bizneset të përfshihen më tepër në mbrojtjen e ambientit. Ka mendime të ndryshme në se duhet të përdorim masa ndëshkimore ose nxitëse, por më e rëndësishme është që njerëzit duan që të bëhet më e lehtë për këdo që të japë kontributin e tij.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij.

- Do të ulin emetimet e karbonit dhe mbeturinat (mbetjet) nga ndërtesat dhe shërbimet e tyre në përputhje me objektivat kombëtare.
- Do ta bëjnë më të lehtë për banorët dhe biznesin për të mbrojtur ambientin duke përfshirë:
 - Zvogëlimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave të tyre.
 - Zvogëlimin e gjurmëve të tyre të karbonit
- Nxitjen e të gjitha zhvillimeve dhe rritjes që të jenë:
 - Të ndjeshme ndaj ambientit, duke përfshirë hapësirat e hapura; karakterin lokal dhe ambientin natyral
 - Sa më pak karbon dhe me mbetje që të jetë e mundur dhe në përgjithësi
 - të nxisin një zhvillim të qëndrueshëm.
- Do të eksplorojnë mënyrën se si zhvillimet e mëdha mund të gjeneronin nxehtësi dhe rrymë për zonat përreth.
- Do të ulin ndotjen nga transporti nëpërmejt të dyjave si uljes së trafikut ashtu dhe përdorimit të makinave më të pastra, duke nxitur ecjen me këmbë, me biçikletë dhe përdorimin e transportit publik.

Si mund të kontribuojnë njerëzit lokalë.

- Të ulin sasinë e energjisë dhe të ujit që përdorin në shtëpi.
- Të ecin me këmbë, me biçikletë ose të përdorin transportin publik duke përfshirë dhe vajtjen/ardhjen në shkollë.
- Të zvogëlojnë mbeturinat dhe të riciklojnë më shumë.
- Të bëjnë pazar lokalisht.
- Të përdorin më tepër trenat se sa aeroplanët, ku është e mundur – Eurostar-i do të jetë tek pragu i derës tonë nga Nëntori 2007.
- Në qoftë se keni biznes, të merrni masa për të zvogëluar ndikimin tuaj tek ambjenti.

Të punojmë së bashku për të menaxhuar popullsinë në rritje.

Qëllimi jonë është të menaxhojmë rritjen, me qëllim që ajo të ndikojë pozitivisht për Camden-in

Përse është kaq e rëndësishme kjo çështje

Popullsia rezidente e Camden-it shpresohet që të rritet 10% midis periudhës së tanishme dhe 2016, në qoftë se vazhdohet me këtë ritëm. Jo kushdo e mirëpret këtë mundësi. Deri në 30% e familjeve aktuale të Camden-it janë të mbipopulluara, krahasuar me 7% në shkallë kombëtare, dhe kërkesa për çdo lloj strehimi social, strehim përkrahës dhe shërbimet rezidenciale janë me të mëdha se çfarë ofrohet. Kjo ndikon tek shëndeti dhe mirëqenia e familjeve dhe ka një impakt në arritjet arsimore të të rinjve.

Disponueshmëria e strehimit të përbalueshëm financiarisht është prioriteti i dorës së parë për njerëzit në bashki, përfshirë dhe ata që kanë të ardhura mesatare. Na duhet të planifikojmë për një popullsi dhe më të madhe, kështu që infrastruktura jonë, shërbimet dhe strehimi duhet të jenë në lartësinë e duhur për të pëballuar sfidën e këtyre kërkesave në rritje.

Çfarë është bërë tashmë

Rizhvillimi i King's Cross-it do të ofrojë 1700 shtëpi të reja, duke përfshirë 750 shtëpi me kosto të përbalueshme dhe 650 objekte për studentët. Por shumica e strehimit të ri vjen nga rizhvillimi i ndërtesave dhe kantjereve ekzistuese. Objektet ekzistuese tashmë janë rizhvilluar për 'përdorim të përzier zhvillimi' – për shembull strehim dhe biznes – dhe për strehim të përmasave familjare.

Council-i përkrah njerëzit që të lëvizin në shtëpi më të vogla dhe ka zhvilluar strehimin e përkrahur për fëmijët që largohen nga kujdesja dhe për adoleshentët delikatë. Për rritur nivelin e shtëpive që ka në gjendje Councili, janë bërë disa propozime që lidhen me punën e rigjenerimit të gjerë e cila përqëndrohet në banesa të përshtatshme. Në Chalcots Estate në Swiss

Cottage, tashmë ka një Skemë Private Financimi prej £144 milion. Council -i po shikon gjithashtu nënpopullimin dhe mbipopullimin për të përdorur sa më mirë strehimin ekzistues të Council-it.

Këto janë disa nga qëllimet specifike që synojmë të arrijmë:

- Rritjen e ofrimit të strehimit me kosto të përballueshëm dhe ta bëjmë strehimin e përkrahur që të punojë më mirë për këdo.
- Rritjen e cilësisë dhe disponueshmërisë të strehimit social.
- Futjen përsëri në përdorim të banesave bosh.
- Parandalimin e fenomenit të mbetjes pa shtëpi.

Çfarë na thanë njerëzit

Strehimi ishte një nga çështjet më të ngritura në konsultim. Shumë njerëz ishin të shqetësuar për rritjen e popullsisë, veçanërisht për një mungesë të strehimit me kosto të përballueshme dhe nevojës për më tepër strehim familjar. Disa njerëz nuk donin që të kishte ndërtime në zonat e tyre dhe njerëz të tjerë donin që banorët ekzistues të kishin prioritet mbi banorët e rinj.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij.

- Do të punojë për të plotësuar sfidat e strehimit në bashki për të gjitha llojet e strehimit në lidhje me shpërndarjen, koston e përballueshme dhe përzierjen e përmasave, duke përfshirë nëpërmjet politikave planifikuese në Kornizën e ardhshme Lokale të Zhvillimit të Council-it.
- Do të sigurojë që të gjitha zhvillimet (ndërtimet) janë të cilësisë së lartë, të qëndrueshme dhe të projektuara në mënyrë sensitive, me një përzierje të përshtatshme përdorimesh dhe të përkrahura nga infrastruktura sociale dhe ekonomike duke përfshirë punësimin, qendrat shëndetësore, qendrat ku kalohet koha e lirë, qendrat e shitjes me pakicë, qendrat arsimore dhe komunitare dhe vendet e hedhjes së plehrave.
- Do të punojë me qiraxhinjtë për të rritur standartet e strehimit social në të gjithë bashkinë dhe të rigjenerojë komplekset individuale të banesave.
- Do të krijojë një partneritet të drejtuar nga Council -i me Pronarët e Rregjistruar për të dhënë me qira banesa sociale dhe me lojtarë të tjerë të strehimit për të trajtuar bashkarisht disponueshmërinë e strehimit dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me to, si siguria e komunitetit dhe efienca e energjisë.

Si mund të kontribuojnë njerzit lokalë

- Duke përdorur shërbimet lokale dhe qendrat (ambjentet) e komunitetit dhe të lagjeve të tjera.
- Duke shqyrtuar mundësinë për të dhënë me qira një dhomë të tepërt apo për të lëvizur tek një strehim më i vogël, në qoftë se, për shembull, rrethanat tuaja familjare kanë ndryshuar.
- Duke qënë mendje hapur për strehimin që mund të jetë jashtë bashkisë.
- Në qoftë se jeni pronar, duke futur përsëri në përdorim banesat boshe.

Një ekonomi e fortë e Camden-it që përfshin këdo

Kjo pjesë bën fjalë për ekonominë e Camden-it dhe çfarë mund të bëhet për të siguruar që bizneset mund të punojnë në mënyrë efektive dhe të sukseshme në bashki. Këtu bëhet gjithashtu fjalë për popullsinë lokale dhe si mund të sigurojmë që ata të kenë mundësinë për të gjetur punë, këtu në Camden ose gjetkë.

Shumë njerëz vijnë në bashki për të punuar, gjë që ndikon tek tregu lokal i punës dhe ka forca ekonomike – globale, kombëtare dhe rajonale – që janë jashtë kontrollit tonë. Por, ka masa të cilat mund t'i marrim lokalisht për të nxitur dhe përkrahur bizneset në bashki dhe për të rritur numrin e njerëzve lokalë që janë në punë. Pjesë e këtij synimi është që të sigurojmë që fëmijët dhe të rinjtë të kenë qasje të një arsimimi të cilësisë së lartë dhe që ata, krahas të rriturve, të shfrytëzojnë në maksimum mundësitë për arsimim të mëtejshëm dhe të lartë, trajnim dhe punësim.

Një ekonomi lokale e fortë.

Qëllimi jonë është që ta bëjmë Camden-in një vend më të mirë për biznes dhe të rrisim aktivitetin e biznesit lokal.

Pse është e rëndësishme kjo çështje

Camden-i tashmë ka një ekonomi me produktivitet të lartë duke kontribuar rreth 1% të GDP kombëtare, por numri i bizneseve ka rënë në vitet e fundit. Shumë nga aktiviteti ekonomik i Camden-it është në 'ekonominë e dijes' përfshirë universitetet, median dhe industritë krijuese. Sektori i shëndetësisë është gjithashtu një punëdhënës lokal i rëndësishëm dhe kemi gjithashtu qendra të bizneseve financiare dhe juridike.

Një ekonomi lokale e fortë është një kontribues i rëndësishëm në cilësinë e jetës nëpërmjet krijimit të vendeve të punës, të ardhurat që ajo u ofron individëve dhe kontributi i saj në shërbimet publike lokale. Kështu që është e rëndësishme për ne të promovojmë Camdenin si vend biznesi - si një vend për fillimin e një biznesi të ri dhe ku investimet e brendshme janë të mirëpritura. Lidhjet e forta midis rritjes ekonomike dhe planifikimit urban njihen gjithashtu dhe janë trajtuar më poshtë dhe në pjesën ku flitet për rritjen.

Çfarë është bërë tashmë

Bizneset Lokale janë përfshirë në një numër partneritetesh, gjë që u jep mundësi për të punuar së bashku me komunitetin dhe shërbimet publike. Këto përfshijnë Distriktet për Përmirësimin e Biznesit në Holborn dhe Camden Town dhe partneritetet fokusohen në Kilburn dhe tek gratë në biznes. Partneriteti i Arsimit dhe Biznesit ofron një lidhje midis shkollave dhe

bizneseve.

Këtu janë disa nga qëllimet që synojmë të arrijmë:

- Rritjen e aktiviteteve tregtare në zonat prioritare të bashkisë.
- Uljen e ritmit të dështimit të biznesit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të bizneseve në bashki.
- Rritjen e mundësive për të filluar biznes midis grupeve të zezakëve dhe të minoriteteve etnike dhe grave në zonat prioritare.
- Rritja e numrit të personave me aftësi të kufizuara dhe të atyre me probleme të shëndetit mendor që futen në punë dhe qëndrojnë në punë me pagesë.
- Të punojmë me bizneset në Camden për të ndihmuar të rinjtë të mësojnë për botën e punës dhe të biznesit.

Çfarë na thanë njerëzit.

Njerëzit kanë thënë se ata çmojnë bizneset e pavarura lokale veçanërisht dyqanet. Bizneset na kanë thënë se çështje të tilla si sistemi i planifikimit dhe krimi janë faktorë shkurajues për t'u vendosur në Camden.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij

- Do të ulë burokracinë për biznesin, veçanërisht duke adoptuar një qëndrim të bazuar në rrezik ndaj inspektimit të Council-it dhe regjimeve kontrolluese.
- Do të ekzaminojë në mënyrë kritike ndikimin e parkimit, planifikimit, kontrollit dhe shërbimeve të tjera statutores në biznese, veçanërisht në dyqanet e pavaruara lokale.
- Do të promovojë Camdenin si një vend të mirë për biznes, për shembull, nëpërmjet Kornizës së ardhshme të Zhvillimit Lokal.
- Do të rishikojë modelin e Distriktit të Përmirësimit të Biznesit krahas qëndrimeve të tjera të menaxhimit të qendrës së qytetit për të investiguar kontributin e tyre të mundshëm në pjesët të tjera të bashkisë.
- Të ndihmojë tregtarët e rinj dhe të vjetër gjatë fillimit të biznesit
- Të punojë për të mbajtur shërbimet ekonomike ekzistuese lokale siç janë postat dhe ATM-të.

Si mund të kontribuojnë njerëzit lokalë.

- Duke përkrahur dyqanet lokale nëpërmjet skemave të kartave të besnikërisë për të blerë mallra dhe shërbime lokalisht.
- Duke kërkuar këshillë, në qoftë se mendoni të krijoni biznesin tuaj.
- Në qoftë se jeni një punëdhënës lokal, duke krijuar më shumë mundësi

për popullsinë lokale.

- Të gjitha bizneset duke u përfshirë në komunitetet dhe vendet ku ato kryejnë aktivitetin e tyre të biznesit

Rrisim aksesin/qasjen e aftësive, arsimit, trajnimit dhe punëve

Qëllimi është që t'u japim mundësi më shumë banorëve të Camden-it për t'u përfshirë me arsim, trajnim dhe punësim

Përse është e rëndësishme kjo çështje

Camden-i ka një ekonomi lokale konkurruese, të madhe dhe të fortë e cila mund të ofrojë dy punë për çdo banor në moshë pune dhe ka një forcë pune lokale shumë të kualifikuar. Por, në të njëjtën kohë, bashkia ka nivele të larta të të qëndruarit pa punë dhe varësia në asistecën sociale të shtetit. Disa nga banorët tanë kanë qënë pa punë për një periudhë të gjatë kohe dhe jo të gjithë të rinjtë e moshës 16 deri 18 vjeç po marrin pjesë në arsim, trajnim ose punësim.

Lufta kundër këtij përjashtimi ekonomik është e rëndësishme, në qoftë se rezidentët e Camden-it duan të përmirësojnë cilësinë e jetës dhe të kontribuojnë më gjerësisht. Për shumë banorë, kjo do të përfshijë përfitimin e aftësive themelore ose trajnimin në gjuhën angleze. Fëmijët e Camden-it dhe të rinjtë duhet të kenë qasje të një gamë më të gjerë kursesh akademike dhe profesionale për të rritur rezultatet e përgjithshme dhe për të rritur zgjedhjet në karrierën e tyre. Në përgjithësi, ne duhet t'i bëjmë njerëzit lokalë më të punësueshëm, me qëllim që ata mund të marrin pjesë në mundësitë e punësimit në bashki.

Çfarë është bërë tashmë

Ka një gamë programesh profesionale dhe mundësi për të mësuar në komunitet në të gjithë bashkinë, përfshirë shumë që zhvillohen në bibliotekat e Camdenit. Sektori i komunitetit dhe ai vullnetar luan gjithashtu një rol të rëndësishëm për të ofruar rrugët për t'u futur në punë me pagesë.

Zyra e Rekrutimit 'Camden Working' ndihmoi 250 banorë që të gjenin punë të qëndrueshme vitin e kaluar, ka dhe një zyrë rekrutimi të NHS-it në Kentish Town. Ka gjithashtu një sërë shërbimesh përkrahjeje për të ndihmuar njerëzit për tu punësuar. Për shembull, në King's Cross ka një qendër rekrutimi për popullsinë lokale për të zhvilluar aftësi dhe të ketë qasje të punëve lokale të ndërtimit.

Camden ka gjithashtu tre kolegje për të rriturit – City Lit, Mary Ward Centre dhe Workin Men's College- të cilët ofrojnë kurse. Ka dhe arsim të mëtejshëm lokal në Westminster Kingsway College, të cilit po i rindërtohet godina e Gray's Inn.

Këtu janë disa nga qëllimet që synojmë të arrijmë:

- Rritjen e standarteve në Anglisht, matematikë dhe shkencë, duke përfshirë numrin e studentëve që marrin të paktën 5 GCSE (nota A* deri në C) dhe arritjen e përgjithshme në arsimin e mesëm dhe të gjitha aspektet e të mësuarit.
- Përmirësimin e nivelit të përgjithshëm të punësimit dhe të kemi sa më pak njerëz të varur nga asistenca sociale e shtetit.
- Të rrisim pjesëmarrjen në aftësitë dhe trajnimin midis grupeve prioritare duke përfshirë ata që marrin Benefit - in e Paaftësisë dhe prindërit e vetëm.
- Të rrisim numrin e të rinjve të moshës 16 deri në 18 që janë në arsim, punësim ose trajnim.
- Të përmirësojmë frekuentimin e shkollës.

Çfarë na thanë njerëzit

Njerëzit donin standarte më të larta në arsim dhe rritjen e mundësive trajnuese dhe profesionale për të rinjtë. Ata thanë se donin shanse të barabarta në punësim, trajnim dhe arsim dhe aftësi më të mira trajnimi duke përfshirë aftësitë për jetën dhe gjuhën angleze. Kujdesja e qasshme dhe me kosto të ulët për fëmijët konsiderohej e rëndësishme për t'u dhënë mundësi prindërve të kenë qasje të punës.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij

- Do të transformojnë arsimin e mesëm në të gjitha shkollat e Camdenit përfshi ndërtimin e një shkolle të re të mesme.
- Do të zgjerojnë fillimin dhe ofrimin e trajnimit të aftësive kryesore dhe themelore, të mësuarit familjar dhe mësimi i gjuhës angleze.
- Do të nxisin të mësuarit profesional dhe të mundësive të tjera për të siguruar që njerëzit, përfshi të rinjtë, të kenë qasje të punësimit, të arsimimit të mëtejshëm dhe mundësive të trajnimit.
- Do të rrisin mundësitë për njerëzit që të futen dhe të qëndrojnë në tregun e punës, përfshirë njerëzit më të vjetër në moshë, kujdestarët, prindërit që kthehen në punë dhe ata që ata që përballen me pengesa të tjera të punësimit, siç janë aftësitë e kufizuara ose ata që janë të sëmurë.
- Do të sigurohen që të jetë e disponueshme kujdesja e qasshme, me cilësi të mirë dhe me kosto të ulët për fëmijët.
- Do të rrisin në maksimum punësimin lokal dhe mundësitë e trajnimit, duke përfshirë çirakllëkun (punë me rrogë të ulët për të mësuar zanatin), të gjeneruara nga Zhvillimi i King's Cross-it, Linja

hekurudhore e Tunelit të Lamanshit dhe Lojërat Olimpike.

Si mund të kontribuojnë njerëzit lokalë.

- Të siguroni që fëmija juaj frekuenton shkollën dhe shkon në shkollë në orarin e caktuar.
- Të rregjistroheni në një kurs trajnimi, të studjoni për një kualifikim ose të mësoni një aftësi të re.
- Të inkurajoni shokët dhe pjestarët e familjes për të zhvilluar arsimimin, aftësitë dhe shanset e tyre të punës.
- Të bëheni vullnetar nëpërmjet vendit tuaj të punës, siç është të lexuarit në shkollën lokale.

Një komunitet i lidhur i Camden- it ku njerëzit bëjnë një jetë aktive dhe të shëndetshme

Ne të gjithë duam të jetojmë dhe punojmë në një vend, ku të ndihemi si në shtëpi tonë. Secili përfiton nga të jetuarit në një zonë, ku njerëzit besojnë dhe respektojnë njëri tjetrin. Nuk është e thënë që të bëhen shokë të ngushtë, por për të krijuar lidhje të mjaftueshme për të pasur një ndjenjë komuniteti.

Është gjithashtu e rëndësishme që njerëzit të kenë mundësinë për të kontribuar në shoqërinë më të gjerë nëpërmjet punës vulnetare dhe duke luajtur një rol më aktiv në demokraci. Kjo pjesë bën fjalë për mënyrën se si ta bëjmë Camden-in një vend me komunitete të lidhura dhe të forta dhe me qytetarë aktivë që bëjnë një jetë të shëndetshme.

T'u japim mundësi njerëzve për të luajtur një rol aktiv në komunitete më të forta lokale.

Qëllimi jonë është që të forcojmë ndjenjën e komunitetit dhe t'u japim njerëzve më shumë mundësi për luajtur një rol aktiv në jetën lokale.

Pse është e rëndësishme kjo çështje

Një jetë e gjallë, e respektueshme dhe e fortë e komunitetit është e rëndësishme për të gjithë ne si individë dhe për demokracinë tonë lokale. Ne të gjithë përfitojmë nga një ndjenjë më e madhe e komunitetit dhe vendimet janë më të mira, në qoftë se ato bazohen më afër nevojave të njerëzve dhe experiencës së bashkisë.

Për të arritur këtë ndjenjë komuniteti, të drejtat e secilit duhet të vlerësohen dhe respektohen. Është e dobishme, nëse të gjithë ne kemi marrëdhënie që i kalojnë kufijtë e lagjes, besimit, etnicitetit dhe aspekteve të tjera të identitetit. Njerëzit gjithashtu duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë aktivisht në vendimarrjen lokale dhe në një sektor komunitar dhe vullnetar të qëndrueshëm, energjik dhe të fortë.

Camden - i është veçanërisht një bashki diverse. Pothuasje një e treta e rezidentëve ka origjinë zezake ose vjen nga minoritetet etnike, një e dhjeta e popullsisë është muslimane dhe ka komunitete të rëndësishme të reja dhe refugjatësh, përfshirë atë nga Somalia. Mbi 90% e rezidentëve thonë se u pëlqen që jetojnë në një vend kaq divers nga ana kulturore. Neve na nevojitet të vazhdojmë të kultivojmë një ndjenjë respekti, integrimi dhe komuniteti midis banorëve tanë dhe t'u japim mundësi sa më shumë njerëzve që të jetë e mundur, që të bëhen pjestarë aktivë në komunitetin tonë lokal dhe në jetën demokratike.

Çfarë është bërë tashmë

Camden-i ka një sektor lokal vullnetar dhe komunitar të gjallë me më shumë se 1500 organizata, shumë prej tyre drejtohen nga vullnetarët. Shumë banorë janë anëtarë aktivë të jetës së komunitetit lokal nëpërmjet organizatave, shoqatave, rrjeteve dhe partneriteteve lokale, megjithëse niveli formal i vullnetarëve është ende më i ulët se mesatarja kombëtare. Bashkia e kapërceu tendencën kombëtare në 2006 duke patur një rritje të pjesëmarrjes në votime për zgjedhjet lokale. Besimi i njerëzve në institucione, siç janë Council -i dhe Policia, po rritet. Dhe banorët thonë që ka një rritje të ndjenjës së komunitetit në lagjet e tyre.

Ka një gamë forumesh që punojnë për të përkrahur dhe nxitur interesat e grupeve të veçanta. Këto grupe përfshijnë Forumin e Homoseksualëve, Lesbikeve, Biseksualëve dhe Transeksualëve të Camden-it dhe Partneritetit të Besimit të Komuniteteve të Camdenit. Ka grupe të qiraxhinjve dhe pronarëve me kontratë të përkohshme, partneritete të lagjeve dhe një Forum Refugjatësh që punon për integrimin e komuniteteve të refugjatëve. Mësimet mbi qytetarinë jepen në të gjitha shkollat tona dhe ambientet e shkollave po bëhen të disponueshme për komunitetin e gjerë jashtë orëve të mësimet. Të rinjtë po përfshihen gjithashtu në këshillat e shkollës dhe në Parlamentin e të Rinjve të Mbretërisë së Bashkuar.

Këto janë disa nga qëllimet që synojmë të arrijmë:

- Më shumë njerëz të punojnë si vullnetarë, të paktën dy orë në javë.
- Më shumë banorë ta ndiejnë që ata mund të kenë ndikimin e tyre në vendimet që prekin zonën e tyre lokale
- Më shumë njerëz ta ndiejnë që zona e tyre lokale është një vend ku njerëz me origjinë të ndryshme shkojnë me njëri-tjetrin.
- Rezidentët të ndiejnë një sens më të madh lidhjeje me Camdenin.
- Më shumë njerëz të votojnë në zgjedhje.

Çfarë na thanë njerëzit

Njerëzit shfaqën një përkrahje të madhe për këdo që ka një rol për të luajtur për ta bërë Camden-in një vend më të mirë për të jetuar. Njerëzit donin gjithashtu të ndikojnë më shumë në vendimet lokale dhe që të ketë një formë të këshillit rinor. Njerëzit gjithashtu na thanë që secili duhet të jetë në gjendje të marrë pjesë dhe jo vetëm pakica që ngre zërin. Na thanë gjithashtu që gjuha angleze është e rëndësishme për ta mbajtur komunitetin tonë divers të bashkuar dhe se ndryshimet kulturore duhen njohur dhe njëkohësisht duhet të nxisin mirëkuptimin.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij.

- Do ta sjellin vendimmarrjen më afër banorëve nëpërmjet forumeve të zonës në të gjithë bashkinë, ku njerëzit mund të ndikojnë tek vendimet dhe shërbimet publike në një gamë çështjesh lokale.

- Do të rrisin punën vullnetare në Camden mbi mesataren kombëtare, do të kultivojnë ndjenjën e vetëndihmesës të komunitetit dhe të rrisin mundësitë për përzierien midis brezave.
- Do të krijojmë Forumin e ri Këshillues të Kohezionit Social për të nxitur komunitete sa më në harmoni dhe të integruara në bashki.
- Do të përmirësojmë qasjen e hapësirave dhe ndërtesave komunitare dhe publike për të mundësuar një bashkëveprim më të madh midis komuniteteve diverse.
- Të integrojmë të ardhurit e rinj, duke përfshirë komunitetet e refugjatëve, në komunitetet lokale dhe në jetën demokratike.
- Të krijojmë një Këshill Rinor për të nxitur pjesëmarrjen dhe përfshirjen e të rinjve në jetën civile dhe do të eksplorojmë gjithashtu opsionet për fëmijët më të vegjël.

Si mund të kontribuojë popullsia lokale

- Duke punuar si vullnetarë ose duke u bërë anëtarë të një grupi, shërbimi apo shoqate lokale dhe duke i nxitur ata të prekin të gjitha sferat e komunitetit.
- Duke votuar në zgjedhjet lokale, Autoritetin Greater London, kombëtare dhe Evropian dhe duke u përfshirë në partitë politike.
- Duke i dhënë pikëpamjet tuaja këshilltarit tuaj lokal ose Deputetit të zonës në lidhje me çështjet që ju interesojnë.
- Duke biseduar me komshijtë tuaj.

Përmirësimi i mirëqënies dhe shëndetit në të gjithë bashkinë

Qëllimi jonë është që të sigurohemi që shëndeti dhe mirëqënia e të gjithë banorëve të Camdenit përmirësohet.

Pse është e rëndësishme kjo çështje

Faktorë të shumtë ndikojnë tek shëndeti jonë dhe tek mundësia e sëmundjes. Shumë nga këto mund të ndikohen nga shërbimet publike, siç janë kushtet e ambjentit dhe strehimit. Shërbimi Kombëtar Shëndetësor (NHS) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve për të trajtuar shumë sëmundje. Megjithatë, aspekte të tjerë të shëndetit mund të përmirësohen

vetëm nga njerëzit vetë, përfshirë ndalimin e duhanit dhe të kenë një mënyrë jetese aktive.

Më shumë mirëqënie e përgjithshme, përfshirë mundësinë për të zhvilluar dhe pasur interesa personale, është e rëndësishme për këdo. Në Camden ne kemi një proporcion relativisht të lartë të njerëzve në moshë pune, veçanërisht të rritur të moshës 20 deri në 44 vjeç, që balancojnë shpesh punën, angazhimet familjare dhe aktivitetet shoqërore, të cilat mund ta bëjnë të vështirë për ta që të lidhen me komunitetin lokal.

Ne kemi gjithashtu dhe grupe të tjera të rëndësishme të popullsisë. Fëmijët dhe të rinjtë janë e ardhmja e bashkisë dhe mirëqënia e tyre është e rëndësishme për të siguruar që ata të zhvillohen në mënyrë maksimale. Të moshuarit, shumë nga të cilët po jetojnë më gjatë, duan të ruajnë një mënyrë jetese të pavarur dhe të kontribuojnë aktivisht në komunitet.

Çfarë është bërë tashmë

Çdo vit Drejtori lokal i Shëndetit Publik vlerëson gjendjen shëndetësore dhe mirëqënien në bashki. Konkluzionet botohen në një raport vjetor që paraqet gjithashtu dhe iniciativat për trajtimin e tyre. Ka prova të forta që ne mund të kemi një ndikim të rëndësishëm në shëndetin e njerëzve nëpërmejt uljes së pirjes e duhanit, uljes së obisitetit, përmirësimit të shëndetit mendor dhe seksual dhe duke ulur dëmin e shkaktuar nga alkooli.

Camdeni ka gjithashtu një Plan të të Rinjve dhe Fëmijëve që fokusohet në rritjen në maksimum të shanseve dhe zgjedhjeve të jetës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë tanë që jetojnë, mësojnë dhe rriten në Camden. Ne gjithashtu punojmë, nëpërmjet kujdesjes sociale dhe mënyrave të tjera për të siguruar që të moshuarit të ruajnë pavarësinë e tyre dhe vazhdojnë të përfshihen në komunitetin lokal.

Këto janë disa nga qëllimet specifike që synojmë të arrijmë:

- Të ulim pirjen e duhanit
- Të nxisim të ngrënit në mënyrë të shëndetshme dhe aktivitetet fizike.
- Të nxisim qasjen e shërbimeve shëndetësore seksuale.
- Të ulim shfaqjen e sëmundjeve si kanceri dhe sëmundjet koronare të zemrës.
- Të sigurojmë që një gamë shërbimesh dhe strehimesh të jenë të disponueshme për të plotësuar nevojat dhe aspiratat e një popullsie që plaket.
- Të minimizojmë shfaqjen e neglizhimit dhe abuzimit të fëmijëve.
- Të rrisim numrin e të rriturve delikatë që banojnë në mënyrë të pavarur në shtëpitë e tyre me përkrahje, në qoftë se është e nevojshme.

Çfarë na thanë njerëzit

Njerëzit mendonin se ata duhet të nxiten që të kujdesen më shumë për shëndetin e tyre, përfshirë dhe marrjen me sport dhe aktivitetet fizike. Pati gjithashtu përkrahje për të nxitur të ngrënit në mënyrë të shëndetëshme.

Pati një mesazh të fortë nga të moshuarit që ata kanë shumë për të kontribuar në shoqëri si qytetarë aktivë dhe duhet bërë më tepër për të shmangur izolimin e të moshuarëve.

Fëmijët dhe të rinjtë ishin veçanërisht të shqetësuar për sigurinë e komunitetit, përmirësimin e mundësive për të rinjtë, shëndetin seksual, bulizmin dhe për të pasur mundësinë për të kontribuar pozitivisht në Camden si një vend për të jetuar, mësuar për t'u rritur. Ata gjithashtu thanë se vendet ku ata shkojnë në kohën e lirë ishin shumë të rëndësishëm, por kostua mund t'i kufizonte ata ndonjëherë.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij.

- Do të marrin masa për të ulur pirjen e duahnit
- Do të nxisin sjelljen e shëndetshme, përfshi të ngrënit në mënyrë të shëndetshme dhe aktivitete fizike.
- Do të ofrojnë mundësi për këdo që të qëndrojnë të shëndetshëm, të vazhdojnë të mësojnë dhe të bëjnë një jetë të plotë dhe active.
- Do të rrisin në maksimum zgjedhjet dhe shanset e jetës për të gjithë fëmijët tanë dhe të rinjtë që jetojnë, mësojnë dhe rriten në Camden.
- Do të punojnë me njerëzit që përballen me efektet e aftësive të kufizuara të sëmundjeve të shëndetit fizik dhe mendor, kështu që ata mund të vazhdojnë të japin një kontribut pozitiv.

Si mund të kontribuojnë njerëzit lokalë

- Duke i bërë ndryshime mënyrës tuaj të jetesës, duke ecur më tepër me këmbë, të ndërmerrni më shumë aktivitete fizike dhe të ndaloni pirjen e duhanit.
- Duke siguruar që fëmijët dhe të rinjtë në kujdesin tuaj të kenë qasje të ushqimit të shëndetshëm dhe të marrin pjesë në aktivitete fizike.
- Duke shfrytëzuar në maksimum aktivitetet e të mësuarit që familjet mund të bëjnë së bashku, të mësuarit jashtë shkollës dhe mundësitë kulturore dhe argëtuese.

Nje Camden i sigurtë që është pjesë e gjallë e qytetit tonë botëror

Camden-i është një pjesë e gjallë dhe vitale e një qyteti botëror që ka me të vërtetë një kapacitet global. Ai është githashtu shtëpia e disa vendeve më të njohura dhe më të dashura të Londrës si Muzeu Britanik, Hampstead Heath dhe Tregu Camden Lock.

King's Cross-i është një zonë e ndryshimit dhe e zhvillimit kolosal dhe do të bëhet një qëndër dhe më e rëndësishme për Londrën dhe për vendin kur lidhja me tren e Eurostar-it hapet më 2007. Camden Town është një tjetër qëndër që paraqet interes për bashkinë, i cili tërheq mijëra vizitorë çdo javë.

Por, Camdeni, si shumë bashki të tjera në qendër të Londrës, ka një nivel relativisht të lartë të krimit dhe të sjelljes anti sociale, veçanërisht në zona të caktuara si Camden Town dhe Bloomsbury. Sfida jonë është të t'i luftojmë këto probleme, dhe në të njëjtën kohë të ruajmë gjallërinë e bashkisë dhe rolin e saj në këtë qytet botëror.

Një pjesë e përparuar dhe e sigurtë e Londrës dhe porta e Evropës.

Qëllimi jonë është ta bëjmë Camdenin një vend të sigurt, ndërkohë që të ruajë gjallërinë e tij.

Pse është e rëndësishme kjo çështje

Camdeni është një vend i gjallë dhe i pasur nga ana kulturore, por gjithashtu dhe një vend ku krimi dhe sjellja antisociale dhe veçanërisht droga, janë shqetësim për shumë njerëz. Camden ka një ekonomi të pasur të natës që mbështetet te pub-et, klubet dhe restaurantet. Një numër i madh vizitorësh vijnë në bashki dhe është një nyjë e madhe ndërlidhëse transporti për Londrën. Kjo e bën më të vështirë sfidën për të mbajtur një ambient urban të cilësisë së lartë, duke përfshirë rrugë të pastra të cilat mund të kontribuojnë për një ndjenjë sigurie. Sfida jonë është të ballancojmë gjallërinë e bashkisë – dhe rolin jonë si një bashki në zemër të Londrës – me nevojën për ta bërë atë dhe më të sigurt se ç'është tani. Kings Cross-i ka veçanërisht një rol të rëndësishëm për të luajtur, si një lagje urbane e rinovuar në qytet.

Çfarë është bërë tashmë

Në përgjithësi krimi ka rënë nën 20% që nga 2003 përmes një kombinimi masash parandaluese dhe zbatuese. Për shembull, rreth 300 trafikantë droge janë arrestuar në 12 muajt e kaluar.

Një numër masash parandaluese po përdoren në bashki, duke përfshirë programet prindërore dhe kontratat e sjelles siç janë Marrëveshjet për Sjellje të Pranueshme. Veprimet parandaluese përfshijnë gjithashtu aktivitetet e

liçensimit për të nxitur një ekonomi diverse dhe të fortë të netëve të vona që garanton sigurinë dhe cilësinë e jetës së banorëve lokalë.

Më shumë se 200 urdhra të sjelljes anti-sociale (ASBO) kanë dalë që nga 1999, krysisht ndaj të rriturve. ASBO-t përdoren si mjet i fundit pas ndërhyrjeve të tjera - siç janë ndërmjetësimi, rehabilitimi dhe aktivitetet që synojnë ndryshimin e sjelljes- kanë dështuar për të përmirësuar sjelljen e personit.

Këto janë disa nga qëllimet specifike që synojmë të arrijmë:

- Uljen në përgjithësi të krimit dhe të sjelljes antisociale, veçanërisht krimin e dhunshëm dhe vjedhjet e dhunshme.
- Uljen e frikës ndaj krimit
- Uljen e numrit të të rriturve dhe të të rinjve që përsëritin veprat penale
- Uljen e dëmit të shkaktuar nga alkooli dhe drogat ilegale.
- Rritjen e numrit të përdoruesve të drogës që ndjekin programet e trajtimit.
- Parandalimin e fëmijëve dhe të rriturve që të pëfshihen në bulizëm, sjellje antisociale dhe krime.

Çfarë na thanë njerëzit

Droga dhe sjellja anti sociale që e shoqëron atë ishin një temë e madhe e konsultimit të publikut. Shumë banorë e ndjenin se këto çështje e dobësojnë rëndë cilësinë e jetës, veçanërisht në disa pjesë të bashkisë. Camden Town ishte përmendur shpesh si zonë me porblemet më të dukshme të drogës. Njerëzit donin të informoheshin për mënyrën se si luftojmë krimin dhe sjelljen antishoqërore dhe donin të ishin pjesë e zgjidhjes. Njerëzit e ndjenien që King's Cross-i duhet të zhvillohet në një mënyrë të tillë që t'i sjellë përfitime popullsisë lokale.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij

- Do të shfrytëzojnë mundësitë për të krijuar një lagje të re dhe interesante për Londrën në King's Cross, përfshi zhvillimin e saj në një qëndër kulturore dhe portë për Londrën.
- Do ta bëjnë më të lehtë për banorët për të lajmëruar rastet e sjelljes antisociale.
- Do të godasin shkaqet e sjelljes antisociale. Për shembull, duke ofruar përkrahje prindërore, e shoqëruar me masa zbatuese.
- Do të përmirësojnë sistemet e monitorimit të incidenteve të racizmit dhe bulizmit dhe të kemi qasje të përkrahjes në lidhje me bulizmin, ngacmimin, racizmin dhe krimin.
- Do të sigurohen që komunitetet diverse të Camdenit luajnë rolin e tyre

që t'i bëjnë më të sigurta lagjet tona.

- Do të zvogëlojnë frikën e krimit duke punuar në partneritet me komunitetin duke u dhënë kompetenca njerëzve të marrin vendime dhe të ofrojnë informacion të saktë rreth sigurisë së komunitetit në zonat lokale.

Si mund të kontribuojnë njerëzit lokalë.

- Të raportoni sjelljen antisociale dhe të mbani qëndrim në komunitetin tuaj lokal.
- Të bëheni Officer Policie ose të punoni si vullnetar me policinë lokale për t'u dhënë mundësi sa më shumë oficerëve të policisë të shkojnë në detyrën e tyre kryesore.
- Të përfshihen në Panelet e Lagjeve të Sigurta ose në Skemat e Shpërblimit të Komunitetit ku banorët mund të vendosin për projekte lokale për personat që kryejnë vepra penale dhe kryejnë dënimin me punë papagesë në komunitet.
- Të kujdesen për një person të ri.
- Të mos blini mallra fals nga tregtarët ilegalë të rrugës.

Vizioni i Camden Town

Camden Town-in, në zemër të bashkisë, e duan disa njerëz, por shumë të tjerë e shikojnë si një vend me probleme të konsiderueshme për të lufuar, veçanërisht drogën. Për këtë arsye, banorët dhe partnerët në Partneritetin Strategjik Lokal kanë zhvilluar një vision për Camden Town për të ndihmuar në përmirësimin e zonës.

Një takim i nivelit të lartë me këshilltarët a zonës u mbajt në Nëntor 2006, si dhe një diskutim i hollësishëm me Forumin e Komunitetit të Camden Town dhe Camden Town Unlimited.

Njerëzit na thanë se Camden Town është një vend unik dhe interesant me një komunitet divers. Por ata thanë gjithashtu se trafikimi i dukshëm dhe agresiv i drogës po prish cilësinë e jetës së banorëve dhe po vë në rrezik suksesin e qendrës që qytetit. Camden Town ka një reputacion ndërkombëtar dhe për një kohë të gjatë si një treg i drogës së hashashit.

Vizioni i komunitetit është për një Camden Town ku trafikimi i drogës, veçanërisht ai i dukshëm, të ulet në mënyrë dramatike dhe karakteri i tij unik ofron diçka për popullsinë lokale dhe vizitorët e të gjitha shijeve dhe moshave. Camden Town ka nevojë të ketë vende ku banorët lokalë mund të blejnë për nevojat e tyre të përditëshme dhe të gjithë kategoritë e njerëzve të joshen nga dyqanet me gamë të gjerë dhe cilësi të lartë. Ekonomia e natës duhet të jetë diçka që duhet të shijohet nga njerëzit e moshës dyzetë dhe pesëdhjetë vjeçare krahas të rinjve. Kur njerëzit mendojnë Camden Town, ata duhet të mendojnë për vende si Roundhouse dhe jo për trafikimin e drogës në rrugë

dhe parregullsinë e përgjithshme. Komunitetet e privuara duhet të marrin pjesë në suksesin e qëndrës së gjallë të qytetit nëpërmjet një sërë mundësish punësimi, veçanërisht në sektorin e shërbimit.

LSP beson se që të arrihet ky vision ka nevojë për një fokus të qartë në rigjenerimin e Camden Town se sa thjet përballjen me problemet. Trafikimi i drogës është qartësisht prioriteti i parë dhe do të luftohet nëpërmjet një sërë ndërhyrjesh:

- Zbatimin e ligjit, duke përfshirë një prezencë më të madhe me uniformë.
- Përmirësimi i gjendjes së ambjentit fizik të Camden Town, duke përfshirë rrugët, trotuaret dhe ndriçimin duke u mbështetur në investimet që janë bërë në këtë zonë nëpërmjet 'banueshmërisë'
- Zbatimin e ligjit kundër trafikantëve të drogës dhe përmirësimet e ambjentit të ndryshojnë reputacionin e zonës, bashkë me një marketing më të mirë të Camden Town-it si një vend ku mund të kënaqet kushdo.

Ndryshimi i Camden Town, për ta bërë atë më të mirë pa humbur atë të mirë që ka ky vend, do të kërkojë ndërhyrje të kujdesshme. Council-i dhe Policia po i përgjigjen sfidës së zbatimit të ligjit. Ka më shumë punë për t'u bërë në ambjentin fizik dhe në reputacionin e zonës. Biznesi dhe banorët mund të kontribuojnë të gjithë për të ndryshuar për mirë Camden Town.

Përfitimi nga mundësitë kulturore dhe argëtuese, përfshirë Lojërat Olimpike të Londrës

Qëllimi jonë është të rrisim mundësitë për rezidentët e Camden-it që të marrin pjesë në aktivitetet e kohës së lirë dhe ato kulturore

Pse është e rëndësishme kjo çështje

Camden është i famshëm për hapësirat e tij të hapura, parqet dhe insitucionet kulturore siç janë Hampstead Heath dhe Muzeu Britanik. Ne kemi dhe një sërë festivalesh të komunitetit dhe ngjarje lolkale gjatë gjithë vitit. Por jo të gjithë komunitetet e Camdenit ndihen të aftë të shijojnë gamën e gjerë të aktiviteteve kulturore dhe të kohës së lirë dhe që janë të disponueshme në bashki.

Në 2012, Evropa kontinentale do të jetë vetëm 2 orë larg nga Camden-i dhe Londra do të jetë organizatore e Lojërave Olimpike dhe Paralimpike. Camden-i është i angazhuar të përdorë Lojërat Olimpike të Londrës si një katalist për të rritur aktivitet kulturore dhe argëtuese në bashki, për t'i bërë ato të disponueshme për njerëzit e të gjitha moshave dhe të sigurohemi që banorët lokale të përfitojnë nga Lojërat Olimpike.

Çfarë është bërë tashmë

Parqet dhe hapësirat e hapura të Camdenit ofrojnë një gamë sporti, ambiente loje dhe ngjarjesh, si dhe janë zona të qeta për t'u shlodhur. Disa parqe – siç janë Waterlow dhe Highgate - kanë fituar çmime për kontributin ndaj komunitetit dhe cilësisë së jetës në përgjithësi.

Ambjentet Sportive janë rregulluar dhe meremetuar në të gjithë bashkinë. Qendra e re e Kalimit të Kohës së Lirë Swiss Cottage tërheq më tepër se 50 000 vizitorë në muaj, Qendra e Sportit e Komunitetit Talacre mbetet një qëndër e rëndësishme për zhvillimin e sportit në Londër dhe Qendra e Sportit Kentish Town po meremetohet.

Ka dhe një numër të madh objektesh kulturore në bashki nga qëndrat siç janë Roundhouse deri tek institucione të tilla si Muzeu Britanik dhe biblioteka të reja ose të meremetuara në Kilburn dhe Kentish Town.

Këto janë disa nga qëllimet specifike që synojmë të arrijmë:

- Më shumë rezidentë të kënaqur me aktivitetet kulturore dhe argëtuese.
- Më shumë rezidentë të kënaqur me ambientet sportive dhe të kohës së lirë.
- Më shumë 5 deri në 16 vjeçarë të marrin pjesë të paktën në dy orë aktivitet të organizuar fizik në javë.
- Zhvillimin e shërbimeve të zgjeruara rreth shkollës për të ndihmuar fëmijët të kënaqen dhe të arrijnë, siç janë klubet e mëngjesit dhe aktivitete pas mësimit.

Çfarë na thënë njerëzit

Banorët thanë se atyre u pëlqenin parqet dhe hapësirat e hapura në Camden, por ishin të lodhur nga aktivitetet e mëdha që mbahen në to. Njerëzit gjithashtu vlerësonin gamën e ambienteve kulturore dhe të kohës së lire të disponueshme në Camden, por ndonjëherë ishin të kufizuar nga kostua dhe çështjet e transportit publik. Ndërsa disa mendonin se Lojërat Olimpike dhe Paralimpike të Londrës mund të ofrojnë mundësi, njerëzit ishin të shqetësuar për koston dhe ishin skeptikë në se banorët e Camdenit do të përfitonin.

Çfarë do të bëjë Council-i dhe partnerët e tij

- Do të sigurojnë që hapësirat tona të hapura dhe institucionet e pasura kulturore dhe trashëgimia arkitektonike të jenë tërheqëse dhe të qasshme për të gjithë, përmes zbulimit të objekteve kulturore 'të fshehura të Camdenit'.
- Do të punojnë së bashku për të krijuar hapësira të reja kulturore përfshi një art publik të cilësisë së lartë, projekte të mira urbane dhe vende tërheqëse dhe të qasshme për të jetuar dhe punuar.

- Duke u mbështetur në të mësuarit në komunitet dhe jashtë shkollës në Camden, do të shfrytëzojmë plotësisht institucionet kulturore lokale përfshi Muzeun Britanik, Bibliotekën Britanike dhe institucionet e arsimit të lartë.
- Të promovojnë Camdenin si një destinacion turistik në vetvete, duke përfituar nga Linja Hekurudhore Tunelit të Lamanshit që hapet në përgatitje për Lojërat Olimike të Londrës.
- Do të shfrytëzojmë në maksimum Lojërat Olimpike dhe Paralimpike të Londrës për banorët dhe bizneset e Camdenit dhe të botojmë një plan veprimi krahas kësaj strategjie, e cila paraqet me hollësi mënyrën se si ne:
 - Do të ndihmojmë fëmijët dhe të rinjtë të jenë më aktivë dhe të shëndetshëm dhe do të krijojmë Forumin e Aftësive të Kufizuara të Camdenit në 2007.
 - Do të përdorim mundësitë kulturore dhe të kalimit të kohës së lirë rreth kohës së hapjes së Linjës Hekurudhore të Tunelit të Lamanshit në St Pancras në 2007 dhe me afrimin e Lojërave Olimpike për të frymëzuar njerëzit dhe për të bashkuar sa më tepër komunitetet tona diverse.
 - Do të rrisim punën vullnetare
 - Do të rrisim në maksimum benefit-et ekonomike të gjeneruara nga Lojërat Olimpike të 2012 për Camdenin duke u përqëndruar në mundësitë për më të rinjtë dhe për biznesin e vogël.
 - Do të përmirësojmë rrugët, parqet dhe hapësirat e hapura për ata që jetojnë dhe punojnë në të gjitha pjesët e bashkisë dhe në përgatitje për shumë njerëz që pritet të vizitojnë qendrën e Londrës më 2012.

Si mund të kontribuojnë njerëzit lokalë

- Duke u përfshirë në aktivitetet kulturore dhe festivalet në parqe.
- Duke u regjistruar në programe vullnetarësh me afrimin e Lojërave Olimpike të Londrës.
- Duke mësuar për muzeun tuaj lokal apo qendrën e artve dhe të çoni shokët/shoqet apo të afërmit tuaj atje herën tjetër.

Kontakte

Për të mësuar më tepër rreth strategjisë së komunitetit ose për të kërkuar një kopje në një format të ndryshëm, lutemi kontaktoni skuadrën e Strategjisë së Komunitetit në:

community.strategy@camden.gov.uk

Community Strategy Team
(Ekipi i Strategjisë së Komunitetit)
Room 305
Camden Town Hall
Judd Street
London WC1H 9BR

Tel: 020 7974 3257
Faks: 020 7974 6057

Linjëteksti, bisedë ose minikom: 020 7974 6866

Për informacion të mëtejshëm rreth Camden Së Bashku shkoni tek
www.camdentogether.org.uk

Përkthimet me shkrim.

Ky dokument, Camden Së Bashku, paraqet vizionin për bashkinë e Camdenit midis 2007 dhe 2012.

Për të marrë një version të Camden Së Bashku në gjuhën tuaj, në shkronja të mëdha, kasetë dëgjimi, ose podcast, lutemi shihni të dhënat e kontaktit më sipër. Lutemi, mbani mend të na thoni emrin tuaj, numrin tuaj të telefonit dhe çfarë formati doni.

Listë Zhargoni

Marrëveshje e Sjelljes së Pranueshme	Pakte vullnetare, kryesisht midis të rinjve që shkaktojnë probleme në zonën në të cilën jetojnë, prindërve të tyre ose gardianëve, autoriteteve lokale dhe policisë.
Urdhërat e sjelljes anti- sociale	Padi civile kundër individëve dhe që kërkohet nëpërmjet sistemit të gjykatës së magjistratorëve. Ai vendos kushte që parandalojnë individët të shkaktojnë frikë dhe panik tek të tjerëve.
ATM-të	Automatet ku tërhiqen paratë ose 'makineri e parave të thata'
Distriktet e Përmirësuar të Biznesit (BIDs)	Partneritete lokale të drejtuara nga biznesi për përmirësimin e ambjentit dhe performancës ekonomike të një zone të caktuar lokale për shembull bizneset mbikëqyrin dhe financojnë përmirësimet siç janë pastrimin e rrugëve, heqjen e mbeturinave, ndriçimin dhe sigurinë publike.

Partneritetit i Biznesit të Camden-it	Ky grup mundëson diskutimet midis Council-it, bizneseve dhe agjensive të tjera që kanë lidhje. Ai ka për qëllim të ndihmojë bizneset të kuptojnë më mirë kërkesat e tyre rregulluese dhe t'u ofrojë atyre një mundësi për të pasur qasje të rrjetit të mundësisve.
Rrjeti i Autorizimit të Komunitetit të Camdenit (CamdenCEN)	Rrjeti i Autorizimit të Komunitetit të Camden -it bashkon organizatat e komunitetit dhe ato vullnetare që punojnë në Camden. Ai ka për qëllim t'u japë mundësi organizatave dhe grupeve komunitare dhe vullnetare të qëndrojnë të përditësuar me çështjet strategjike dhe të ndikojnë tek planifikimi strategjik dhe vendimmarrja në bashki.
Trusti i Kujdesjes Primare të Camdenit (PCT)	PCT e Camdenit është përgjegjëse për të gjitha shërbimet primare dhe komunitare të kujdesjes shëndetësore për Bashkinë e Camden-it. Kujdesi Primar përfshin farmacistët, dentistët, okulistët dhe doktorët e familjes. Kujdesja komunitare përfshin shërbimet siç janë vizitat shëndetësore infermiera e distriktit. PCT kryen gjithashtu shërbime akute dhe të shëndetit mendor për popullsinë e Camdenit.
Camden Së Bashku	Emri i strategjisë së qëndrueshme të komunitetit 2007-2012.
Forumi i Komunitetit të Camden Town	Një grup, që përfshin banorët, i cili trajton çështjet e sigurisë dhe rigjenerimit në Camden Town.
Camden Town Unlimited	Distrikti i Përmirësimit të Biznesit (shih përkufizimin më lart) që ndodhet në Camden Town
Zyra e rekrutimit Camden Working	Një shërbim pune, me një qendër rekrutimi në Camden Town, që gjen punë të vërteta për njerëzit që banojnë në bashkinë e Camdenit.
Gjurma e Carbonit	Një term që përdoret për të përshkruar impaktin e individëve ose të organizatave në ambient dhe shkalla me të cilën ata shkaktajnë emetime të dioksidit të karbonit nëpërmjet veprimeve të tyre.
Partneriteti i Fëmijëve dhe të Rinjve	Bordi i Partneritetit të Fëmijëve dhe të Rinjve mbikëqyr zbatimin e Planit të Fëmijëve dhe të Rinjve të Camdenit.
Skemat e Shpërblimit të Komunitetit	Shpërblimi i Komunitetit është një partneritet midis Kujdestarisë së Londrës, Shërbimit të Policisë Metropolitane dhe autoriteteve lokale. Ai bën të mundur që puna e papaguar nga personat që dënohen me punë në komunitet të marrë njohje nga publiku dhe e lejon publikun të kontribuojë me ide për projektet e punës.
Plani i Korporatës së Councilit	Plani që paraqet qëllimet dhe objektivat e Council-it të Camdenit
Këshilltarët	Anëtarët politikë të zgjedhur të Councilit. Ka 54 këshilltarë të Councilit.

Partneriteti Biznes Arsim	Ky partneritet zhvillon lidhjet midis shkollave, bizneseve dhe organizatatve të komunitetit
Programet e Përkrahjes së Biznesit	Një paketë përkrahjeje ofruar nga Council-i individëve që kanë për qëllim të merren me biznes.
Partneriteti i Besimit të Komuniteteve të Camdenit	Një partneritet i pavarur që përbëhet nga grupet e të gjitha besimeve kryesore në Camden.
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto - një mënyrë për të matur të ardhurat e Mbretërisë së Bashkuar.
Forumi i Lesbikeve, Homoseksualëve, Biseksualëve dhe Transeksualëve (LGBT Forum)	Ky forum përfaqëson pikëpamjet e këtyre grupeve brënda bashkisë
Banueshmëria	Shkalla me të cilën një qytet ose vend është i qasshëm, i pastër dhe i sigurt dhe një vend ku njerëzit zgjedhin të banojnë dhe punojnë. Ka financim të disponueshëm të qeverisë qendrore për projekte që përmirësojnë banueshmërinë.
Marrëveshja e Zonës Lokale (LAA)	LAA paraqet prioritet për një zonë të caktuar që është rënë dakord midis qeverisë qendrore, autoritetit lokal, Partneritetit Strategjik Lokal dhe partnerëve të tjerë kryesorë në nivel lokal. LAA thjeshtojnë disa financime qendrore, ndihmojnë në bashkimin më efektiv të shërbimeve publike dhe lejojnë fleksibilitet më të madh për zgjidhje lokale të rrethanave lokale. Ato përmbajnë një sërë objektivash të cilat monitorohen rregullisht.
Korniza e Zhvillimit Lokal	Dokumenti strategjik kryesor për sistemin e planifikimit të bashkisë dhe për mënyrën si përdoret toka lokalisht. Kjo kornizë zëvendëson Kornizën e Zhvillimit Unitar.
Partneriteti Strategjik Lokal	Partneriteti Startegjik Lokal i Camdenit (LSP) bashkon sektorët komunitar, vullnetar, privatë dhe publik në Camden për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë ata që jetojnë, punojnë dhe vizitojnë bashkinë.
Zyrë rekrutimi e NHS	Një shërbim punësimi lokal ofruar nga PCT e Camdenit që ndodhet në Kentish Town. Ai ndihmon popullsinë lokale të punësohet brënda NHS-it lokal.

Iniciativa e Financimit Privat	Një kontratë ligjore për përfshirjen e kompanive private në ofrimin e shërbimeve publike, vecanërisht ndërtesat publike. Konsortiume private, zakonisht përfshin firma të mëdha ndërtimi, që janë kontraktuar për projektimin, ndërtimin dhe në disa raste menaxhimin e projekteve të reja. Kontratat zakonisht zgjasin për 30 vjet, kohë gjatë së cilës ndërtesa merret me qira nga një autoritet publik.
Forumi i Refugjatit	Një grup i përbërë prej shumë agjensish që përfshin përfaqësues nga Council - i, PCT, Jobcentre Plus, Councili i Aftësive dhe të Mësuarit dhe organizatat e refugjatëve. Ai synon zhvillimin e një qëndrimi strategjik për integrimin e suksesshëm të refugjatëve në bashki.
Pronarët e Regjistruar Socialë	Organizatat të regjistruara dhe të aprovuara nga Korparata e Strehimit për të ofruar strehimin social me qira. Për më tepër, disa RLS ndërtojnë banesa me kosto të ulët, shpesh në partneritet me ndërtuesit komercialë, për t'i shitur mbi bazën e pronësisë së përbashkët.
Roundhouse	Një qëndër në Comden Town që paraqet një program ngjarjesh përshirë muzikë dhe teatër.
Panelet për një Lagje më të Sigurt	Forumet që menaxhohen nga Policia Metropolitane e cila ka për qëllim marrjen e mendimeve nga banorët lokalë për identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve shqetësuese në lagjet e tyre. Ka 18 forume në Camden – një në secilën zonë.
Forumi Këshillues i Kohesionit Social	Një forum i ri për të nxitur më shumë integrim dhe më shumë harmoni midis komuniteteve brënda Camdenit
Qëndrueshmëria	Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm është që t'u japë mundësi të gjithë njerëzve në të gjithë botën të plotësojnë nevojat e tyre themelore dhe të kenë një cilësi më të mirë jete, pa kompromentuar cilësinë e jetës të brezave të ardhshëm. Kjo përfshin mbrojtjen dhe përmirësimin e ambientit natyral dhe fizik dhe përdorimin e burimeve natyrore dhe të energjisë në mënyrë sa më të efektshme që të jetë e mundur.
Strategjia e Qëndrueshme e Komunitetit	Një plan parashikimi që ka për qëllim të përmirësojë mirëqënien ekonomike, sociale dhe ambientaliste të bashkisë. Është një dokument statutor që paraqet vizionin dhe prioritetet në zonën lokale që drejtohet nga Council-i dhe partneriteti strategjik.
I papunë	Një term që përdoret për të përshkruar individë që janë pa punë ose pa punësim

